



KONFERENCA E PARË, 15.06.2017


“SHËNDETI I GJIMNAZISTËVE DHE STUDIME TË INTEGRUARA TË FUSHAVE BIOMJEKËSORE”

SHKOLLA E MESME JOPUBLIKE “IBRAHIM KODRA”, DURRËS

LËNDA: BIOLOGJI

PROJEKT Nr. 2


**Tema: “Sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe
parandalimi i tyre”**



**Punoi: Inva XHAFA
Mirka TRIFONI
Helga JOANIDHI**


Udhëhoqi: Dr. Laura GJYLI

Durrës, 2017




➤ *Objektivat e Realizuara*


- Trajtimi i organeve riprodhuese;
- Moshë aktive seksuale;
- Sëmundjet seksuale të transmetueshme si koncept;
- Trajtimi i çdo sëmundjeje në veçanti;
- Shkaqet ;
- Simptomat e çdo sëmundjeje;
- Metodën e kurimit;
- Metodën kontrceptive dhe parandalimi i SST;
- Aspektet psikologjike;
- Statistikat ;
- Studimet e fundit shkencore .







•Organet riprodhuese tek meshkujt



•Organet riprodhuese tek femrat




Zhvillimi dhe ndërtimi i spermatozoidëve dhe vezës



Veza e maturuar është 1500 µm (1.5 cm), kurse spermatozoidi është 10X më i vogël 50 µm (0.05cm)

Spermatogjeneza

Ovogjeneza



Ndryshimet midis spermatogenezës dhe ovogenezës

	Spermatogjeneza	Ovogjeneza
• Vendndodhja	Teste	Vezore
• Nr. i gametëve të prodhuar	Prodohen miliona gamete	Deri në 400 gamete të maturuar
• Fillimi i procesit	Gjatë pubertetit	Gjatë zhvillimit fetal
• Koha e formimit të gametëve	Proçes i vazhdueshëm	Një herë në muaj (gjatë ciklit menstrual)
• Përfundimi i procesit	Për gjatë gjithë jetës	Gjatë menopauzës
• Koha e çlirimit të gametëve	Në cdo kohë	Një herë në muaj
• Ndarja meiotike	E pandërprerë	E ndërprerë
• Numri i gametëve për një qelizë	Katër	Një


Çfarë janë SST?

SST janë infeksione ose sëmundje infektive, të cilat transmetohen nga një person tek një tjetër me anë të rrugëve seksuale. Ato janë shumë të zakonshme dhe shumë njerëz që i kanë këto sëmundje nuk shfaqin simptoma. Sëmundjet seksualisht të trasmetueshme mund të jenë të rrezikshme, por janë të lehta për t'u diagnostikuar dhe për t'u kuruar.

Mostrajtimi i SST rrit rrezikun e infektimit me një sëmundje tjetër seksualisht të trasmetueshme si HIV-i. Kjo ndodh sepse një SST mund të stimulojë një përgjigje imune në zonën gjenitale ose shkakton dhembje, të cilat rrisin rrezikun e të marrit HIV me anë të rrugëve seksuale. Mostrajtimi i SST shpie në infertilitet (paaftësi për lënë pasardhës).

Disa nga SST janë:

- Klamidioza;
- Gonorreja;
- Sifilizi;
- SIDA, HIV-AIDS;
- Hepatiti B;
- Lythet gjenitale, *Papillomavirus*.



Çfarë është Klamidioza dhe si transmetohet?

- Klamidioza është një sëmundje seksualisht e transmetueshme.
- Shkaktohet nga bakteri *Chlamydia trachomatis*.
- Ajo mund të infektojë si meshkujt ashtu edhe femrat.
- Tek femrat klamidioza zhvillohet në cerviks (qafa e mitrës), rektum, ose në fyt.
- Meshkujt mund ta marrin klamidian nga uretra (brenda penisit), në rektum, ose në fyt.

Si transmetohet klamidioza?


Klamidioza mund të transmetohet gjatë marrëdhënieve seksuale. Një femër mund t'ia transmetojë këtë virus edhe fëmijës gjatë lindjes natyrale. Edhe nëse marret trajtimi për mbrojtjen ndaj klamidiozës, ekziston rreziku i infektimit për herë të dytë.



Chlamydia trachomatis

Simptomat e Klamidiozës

- Simptomat tek femrat përfshijnë:
 - Shkarkime jonormale vaginale, të cilat mund të kenë erë të fortë,
 - Djegie urinare,
 - Dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale,
 - Nëse infeksioni përhapet, mund të keni dhimbje të barkut, dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale, ethe.
- Simptomat tek meshkujt përfshijnë:
 - Shkarkim nga penisi,
 - Djegie urinare,
 - Dhimbje dhe ënjtje në një ose të dy testikujt,
 - Nëse klamidia infekton rektumin, mund të shkaktojë dhimbje, shkarkim dhe gjakderdhje të zorrës së trashë.



Çfarë është Gonorreja?

Gonorrhea është një sëmundje seksualisht e transmetueshme. Është më e përhapur tek të rinjtë. Bakteri i cili shkakton gonorrhenë, *Neisseria gonorrhoeae* mund të infektojë kanalën genitale, gojën ose anusin.

Si transmetohet Gonorreja?

Gonorrhea mund të transmetohet nga marrëdhëniet seksuale me një partner të infektuar. Një grua shtatzanë mund t'ia kalojë femijës gjatë lindjes natyrale.


Simptomat e Gonorresë

○ Simptomat tek meshkujt përfshijnë:

- Dhimbje gjatë urinimit.
- Probleme me prostatën.

○ Simptomat tek femrat përfshijnë:

- Fillimisht janë të lehta,
- Gjakderdhje midis periodave,
- Dhembje urinare.



Neisseria gonorrhoeae

Nëse nuk trajtohet, mund të shkaktoj sëmundje inflamatore pelvike, e cila shkakton probleme me shtatzaninë dhe sterilitetin.

Çfarë është Sifilizi?

- Sifilizi është një sëmundje seksualisht e transmetueshme.
- Shkaktohet nga një mikrob (bakter) i quajtur *Treponema pallidum*.
- Ajo infekton zonën genitale, buzët, gojën ose anusin tek meshkujt dhe femrat. Sifilizi mund të transmetohet gjatë marrëdhënieve seksuale. Një femër mund t'ia transmetojë këtë virus edhe fëmijës gjatë lindjes.


Simptomat:

- Në fazat e para të Sifilizit zakonisht kemi të bëjmë me plagë të vogla. Ajo shkakton ënjtje tek nyjet limfatike dhe skuqje në lëkurë. Shumë njerëz nuk i vënë re simptomat për vite me radhë.
- Plagët e shkaktuara nga Sifilizi mund të rrisin rrezikun për transmetimin e HIV. Nëse je shtatzënë ,sëmundja,mund të të shkaktojë defekte në lindje, ose mund të humbisni fetusin. Në raste të rrarha Sifilizi mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze që mund të të shkaktojnë edhe vdekjen.
- Sifilizi është i lehtë për t'u kuruar nëse diagnostikohet shpejt.



Çfarë është *HIV*?

- HIV (*Human Immunodeficiency Virus*) quhet Virusi Imunodeficiency humane, është një virus që shkatërron disa qeliza të sistemit imunitar të njeriut. Kur je i infektuar me HIV, je më i prirur për të marrë sëmundje të rënda që çojnë deri në vdekje, personi vdes nga infeksione dytësore, për arsye të rënies së imunitetit.
- Virusi, pasi merret qëndron në trupin e të infektuarit gjatë gjithë jetës. HIV nuk mund të kurohet por disa mjekime mund thjesht të rrisin jetëgjatësinë dhe mund të ulin rrezikun e transmetimit të virusit.





Ku gjendet virusi HIV?

- Virusi HIV mund të gjendet tek meshkujt në spermë dhe gjak, ndërsa tek femrat mund të gjendet në sekrecionet vaginale, gjak dhe tek qumështi i gjirit.

Si transmetohet HIV?

- Me anë të rrugëve seksuale.
- Me anë të gjilpërave të përdorura nga personat e infektuar me HIV.
- Gjatë shtatëzisë, lindjes ose të ushqyerit me gji nga nëna tek fëmija.
- **Nuk** transmetohet me anë të ajrit dhe kontaktit fizik, kështu që ju nuk mund ta merrni virusin me anë të përqaftimeve, puthjeve, të përdorurit lugën ose pirunin e personit të infektuar etj. Më parë transfuzioni i gjakut nuk ishte kaq i sigurt sa sot, ndaj disa njerëz janë infektuar me HIV gjatë procesit të marrjes së gjakut. Në ditët e sotme doktorët, spitalet dhe qendrat e dhurimit të gjaku nuk lejojnë të përdorin gjilpërat më shumë se një herë dhe gjaku i dhuruar duhet patjetër të testohet për mundësinë e të paturit HIV ose infeksione të tjera.



Çfarë është *HEPATITI B (HBV)*?

Hepatiti B është një virus që gjendet në gjak, në spermë dhe në sekrecionet vaginale të të infektuarve.

Si transmetohet *Hepatiti B*?

- Lindjes (nga nëna te fëmija)
- Pajisjeve mjekësore, dentare, ato për tatuazhe ose për *piercing* (shpime në trup) që nuk janë sterilizuar siç duhet
- Gjilpërave, brisqeve, limave e prerëseve të thonjve, furçave të dhëmbëve dhe çdo gjëje tjetër që e përdorim me të infektuarin e që mund të përçojë një njollë të vockël gjaku nëpërmjet të çarave të lëkurës
- Marrëdhënieve seksuale

HBV-ja nuk përhapet nga insektet ose nga kolla, prekja e duarve, përqafimi, puthjet në faqe, qumështi i gjirit, nga ngrënia në të njëjtën pjatë. Shumica e të rriturve shërohen nga HBV-ja akute dhe fitojnë imunitet ndaj tij. Nëse nuk kurohet, hepatiti B mund të çojë në mosfunksionim të mëlçisë (cirrozë ose kancer të mëlçisë) dhe në vdekje. Ai mund të parandalohet me anë të vaksinimit.

Tabela e Vaksinimit							
Data e vaksinimit	BCG	Hep B	Meas/Rub	MMR	DTP	OPV POLIO	DT
<u>Ditën e lindjes</u>	PO	Po					
2 Muajsh		Po			Po	Po	
4 Muajsh					Po	Po	
6 Muajsh		Po					
1 Vjec			Po				
2 Vjec					Po	Po	
5 Vjec				Po			
6 Vjec						Po	Po

Çfarë është HPV?

HPV (*Human Papillomavirus*) është një nga infeksionet seksualisht të transmetueshme më të zakonshme. HPV është aq i përhapur sa afërsisht çdo person me një jetë seksuale aktive e ka në një periudhë të jetës së tij. Ka disa lloje tipesh HPV. Disa nga këto lloje mund të shkaktojnë probleme shëndetësore si lythat genitalë dhe kancer. Për të parandaluar këto probleme përdoren vaksinat.

Si përhapet HPV?

HPV mund të përhapet me anë të marrëdhënieve seksuale me dikë që e ka këtë virus. HPV mund të transmetohet edhe nga një person i infektuar i cili nuk ka shenja ose simptoma të kësaj sëmundje.


A shkakton HPV probleme shëndetësore?

Në shumicën e rasteve, HPV largohet vetë pa shkakuar probleme shëndetësore. Nëse HPV nuk largohet atëherë shkakton probleme shëndetësore si lythat genital ose kancer.

Lythat genital shfaqen në formën e flluskave në zonën gjenitale.


A e shkakton HPV kancer?

HPV mund të shkaktojë kancer të qafës së mitrës ose të disa llojeve të tjera. Kanceri te një person i infektuar me HPV do vite të zhvillohet. Tipi i HPV që shkakton lythat genital është i ndryshëm nga tipi i HPV që shkakton kancerin. Njerëzit me imunitet të dobët nuk janë në gjendje ta luftojnë HPV. Këto persona kanë probabilitet më të madh për të pasur problem shëndetësore të shkaktuara nga HPV.



Metodat kontraseptive

Planifikimi sipas ciklit menstrual



Unaza vaginale



Female condoms



Fasho kontraseptive



Prezevativi



Injektione



Pilula orale



Aparati kontraseptiv
Intrauterin




Aparati kontraseptiv Intrauterin (IUD)

- Ka formën e T dhe vendoset vetëm nga një specialist.
- Koka e tij lëshon jonë bakri të cilat ndalojnë lëvizjen e spermatozoidëve në mitër.
- Vezët vazhdojnë të formohen cdo muaj

Avantazhet :

- ❑ Mund të qëndroj në vend nga 5 – 10 vite, por mund të hiqet në cdo kohë;
- ❑ Është një nga metodat më efektive (99 %);
- ❑ Nuk ndikon tek ilaçet e tjera;
- ❑ Mund të përdoret edhe si kontraseptiv emergjence
- ❑ Nuk ndikon tek nëna ose fëmija gjatë ushqyerjes me gji.
- ❑ Fertiliteti rikthehet në nivelet normale pas heqjes së aparatit



Prezervativi tek meshkujt

- Është një nga metodat më të përdorura ditët e sotme. Ato janë të lehtë për t'u mbajtur me vete dhe nuk kushtojnë shumë.
- Prezervativi është e vetmja metodë kontraceptive e cila të mbron njëkohësisht si nga një shtatëzani e padëshiruar, ashtu edhe nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
- Përdoret në çdo kohë;
- Nuk ndikon tek ilacet e tjera;
- Është i lehtë për t'u përdorur ;
- Është efektiv në 82 % të rasteve.





Pilula kontraceptive

- ❑ Pilula është një tjetër metode kontraceptive;
- ❑ Ajo duhet të merret cdo ditë pavarësisht aktivitetit seksual;
- ❑ Pilulat përmbajnë estrogen dhe progjesteron. Kështu ato parandalojnë formimin e vezëve ;
- ❑ Pilulat gjithashtu rrisin dendësinë e mukusit në qafën e mitrës duke parandaluar kështu dhe futjen e spermatozoidëve;
- ❑ Ato janë shumë efektive nëqoftëse përdoren sipas udhëzimeve (92 %);
- ❑ Janë të lehta në përdorim;
- ❑ Disa pilula mund edhe të ndalojnë reduktojnë dhimbjet menstruale;
- ❑ Mund të përdoren për një kohë të gjatë.




Sterilizimi


- ❑ Sterilizimi është një metodë kontraceptive e përhershme;
- ❑ Është e përshtatshme për njerëzit të cilët kanë vendosur për të mos bërë më fëmijë ;
- ❑ Sterilizimi është i mundur edhe për femrat edhe për meshkujt ;
- ❑ Kjo metodë është efektive në 99% të rasteve.
- ❑ Nuk ndikon tek ilaçet e tjera ;
- ❑ Mund të kryhet vetëm nga një specialist.



Statistika



Statistika



Global summary of the AIDS epidemic | 2015

Number of people living with HIV in 2015	Total	36.7 million	[34.0 million – 39.8 million]
	Adults	34.9 million	[32.4 million – 37.9 million]
	Women (15+)	17.8 million	[16.4 million – 19.4 million]
	Children (<15 years)	1.8 million	[1.5 million – 2.0 million]

People newly infected with HIV in 2015	Total	2.1 million	[1.8 million – 2.4 million]
	Adults	1.9 million	[1.7 million – 2.2 million]
	Children (<15 years)	150 000	[110 000 – 190 000]

AIDS deaths in 2015	Total	1.1 million	[940 000 – 1.3 million]
	Adults	1.0 million	[840 000 – 1.2 million]
	Children (<15 years)	110 000	[84 000 – 130 000]

Bibliografia

- <https://medlineplus.gov/sexuallytransmitteddiseases.html>
- <http://www.mayoclinic.org/diseases-conditions/sexually-transmitted-diseases-stds/in-depth/std-symptoms/art-20047081>
- https://en.wikipedia.org/wiki/Sexually_transmitted_infection
- <https://www.plannedparenthood.org/learn/stds-hiv-safer-sex/hiv-aids>
- <https://www.optionsforsexualhealth.org/birth-control-pregnancy/birth-control-options>
- <https://www.womenshealth.gov/a-z-topics/birth-control-methods>
- <http://www.advocatesforyouth.org/topics-issues/contraceptives/1278>
- <https://www.cdc.gov/hiv/statistics/overview/ataglance.html>

Faleminderit p r v emendjen!

